

“Mjedisi Sot”
Nr 2204 E Premte 28/09/2007

Pergatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Kati III
Kutia postare 127, Tirane
Tel/Faks (+355 4) 23 29 28
Email: info@albania.rec.org
Web: <http://albania.rec.org>
www.mjedisisot.info

PERMBAJTJA

NGA VENDI

- Shkoder, banoret, proteste per mbetjet urbane
- Shkoder, ujerat e zeza vershojne mes pallatesh, kerkohet ndihma e bashkise
- Fier, zjarri rrezikon parkun arkeologjik ne Apoloni

NGA BOTA

- Franca do te diskutoje politikat e ardhshme per mjedisin
- Konference mbi ndryshimet klimatike

Njoftime

- 11th international specialized conference on watershed & river basin management

Te gjitha OJF-te mjedisore dhe ato qe kryejne aktivitete per mjedisin, jane te mirepritura te dergojne informacione ose njoftime, ne adresen ‘Mjedisi Sot’ info@albania.REC.org, ose Kutia Postare 127, Tirane.

Pergatitja e lajmeve ditore eshte mundesuar ne saje te mbeshtetjes nga Agjencia Spanjolle per Bashkepunim Nderkombetar – AECI.

Nga VENDI

SHKODER, Banoret, proteste per mbetjet urbane
Gazeta Shqiptare, fq. 22

Dhjetëra banorë që jetojnë prej shumë vitesh në afërsi të Varrezave të Deshmorëve të Shkodrës, protestojnë për rihedhjen dhe djegien e mbeturinave urbane të këtij qyteti në zonën e tyre. Pas përfundimit të kontratës së Bashkisë së qytetit verior me komunën e Gurit të Zi, është rikthyer dhe një herë problemi i mpërthetë që shqetëson prej vitesh këtë institucion, për gjetjen e një vendi për grumbullimin e plehrave. E ndërsa komunat afër qytetit kanë refuzuar të japin vende bosh, bashkiaket kanë filluar të derdhin mbeturinat në vendin e dikurshëm dhe pikerisht në afërsi të varrezave. Marrja e një vendimi të tillë ka indinjuar banorët e kësaj zone, pasi nga djegia e mbeturinave urbane ndodet gjithë ambienti përreth dhe rrezikohet seriozisht jeta e tyre dhe kryesisht e fëmijëve. “Ketu nuk ka asnjë mëter vend për hedhjen e mbeturinave, ndërsa prej disa ditësh ato po grumbullohen dhe digjen në këtë zonë. Nga djegia e tyre krijohen shtellunga të mëdha e të zeza tymi, dhe në jemi të detyruar të mos mbajmë hapur as dyert dhe dritaret nga era e keqe që kundermon gjithandëj”, - shprehën banorët. Gjatë tubimit të zhvilluar dy ditë më parë, ata kanë kërkuar që Bashkia e Shkodrës të gjejë një vend tjetër për grumbullimin e mbeturinave urbane të qytetit. Sipas protestuesve, tymi që vazhdon përgjatë gjithë kohës mbulon dhe zonën e Bardhajvës, stacionin e trenit, lagjen “Mark Lulaj” dhe fshatin Kuc të këtij rrethi. Në fakt ka qenë Prefektura e Shkodrës, e cila në prill të këtij viti urdheroi që plehrat të mos hidheshin në vendin pranë Varrezave të Deshmorëve të qytetit. Por, ky urdher është zbatuar vetëm për 5 muaj.

SHKODER, Ujerat e zeza vërshojnë mes pallatësh, kërkohet ndihma e Bashkisë
Gazeta Shqiptare, fq. 22

Që prej 10 ditësh, banorët e një blloku pallatësh në rrugën “Halit Bajraktari” të Shkodrës po bashkejetojnë me ujerat e zeza. Bllokimi i një pusete si dhe problemet e trashëguara prej vitesh nga kanalizimet, kanë bërë që i gjithë blloku të përmytet nga këto ujera të pista. Të gjendur para një situatë të tillë, banorët kanë vendosur gurë të mëdhenj dhe dërrasa në rrugë, për të shmangur kontaktin me pellgjet e ndyra. Por, ndotja e ambientit rrezikon me shumë fëmijet, të cilët për çdo ditë kalojnë përmes ujerave të zeza. “Situata është alarmante, ndaj jemi ankuar tek drejtuesit e bashkisë si dhe tek krerët e Ndermarrjes së Ujesjellesit. Por, ankesat tona kanë rënë në vesh të shurdher, pasi deri tani nuk është marrë asnjë masë”, - pohojnë banorët. Nderkaq, ata kërkojnë të nderhyhet menjëherë për zgjidhjen e këtij problemi. Burime nga Ndermarrja e Ujesjellesit bëjnë me dije, se nuk ka fonde për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimeve të ujerave të zeza.

FIER, ZJARRI RREZIKON PARKUN ARKEOLOGJIK NE APOLONI
Top Channel

Një zjarr ka rënë sot në afërsi të Parkut Arkeologjik në Apoloni, duke rrezikuar seriozisht këtë pasuri kombëtare. Flaket kanë përfshirë rreth 10 ha shkurre, nderkohe që zjarrfikësit e kanë shumë të vështirë që të nderhyjnë për shkak të terrenit. Sipas informacioneve të fundit, pranë vendit të ngjarjes degjohen edhe shpërthime nga mbetjet e armatimeve të vitit 1997.

NGA BOTA

FRANCA DO TE DISKUTOJE POLITIKAT E ARDHSHE PER MJEDISIN ENDS Europe DAILY 2396

Gjashte grupe pune, te krijuara nga qeveria franceze dy muaj me pare me qellim riperaktimin e politikës franceze per mjedisin, kane paraqitur rekomandimet e tyre, te cilat do te publikohen per konsultim me publikin deri ne fund te tetorit.

Rekomandimet jane dhene nga nje grup aktoresh te interesuar, ku perfshihen perfaqesues te industrise dhe OJFve qe operojne ne fusha si ndryshimet klimatike, energjia dhe biodiversiteti. Ata keshillojne qeverine te reduktoje perdorimin e energjise ne te gjithe sektoret, vecanerisht ne ndertesa dhe ne vendet e punes.

Rekomandimet e tjera perfshijne bllokimin e dritave inkadeshente deri ne vitin 2010-te, reduktimin e perdorimit te pleheruesve ne bujqesi, reduktimin e shkarkimeve te ndotesve si nitratet, PCB dhe metalet e renda. Mbrojtja e biodiversitetit eshte nder ceshtjet prioritare, gjithashtu.

Qeveria do t'i perdore keto rekomandime per te pergatitur nje plan veprimi me 15-20 masa, qe pritet te dalin deri ne fund te muajit tjetër. Por se pari, ajo kerkon te zhvilloje nje konsultim publik mbi kete plan.

Rekomandimet do t'i paraqiten dhe komisioneve parlamentare, partive politike dhe Organizates per Zhvillim dhe Bashkepunim Ekonomik, me qender ne Paris.

Per me shume informacion:

http://www.ecologie.gouv.fr:80/IMG/pdf/Dossier_de_presse_Grenelle_septembre2007.pdf

Konference mbi ndryshimet klimatike

Ndotesit me te medhenj te ambientit ne bote, Shtetet e Bashkuara, India dhe Kina po takohen ne Washington ne nje konference mbi ndryshimet klimatike.

Sekretarja amerikane e Shtetit Kondoliza Rajs tha ne hapje te takimit te sotem se Shtetet e Bashkuara mbeshtesin synimet e takimit te nivelit te larte mbi ndryshimet e klimes te mbajtur te henen ne Nju Jork. Por ajo shtoi se qasja e tanishme globale per kufizimin e nxjerrjes se gazeve qe shkaktojne efektin sere nuk eshte e qendrueshme.

Zonja Rajs argumentoi se secili vend duhet te vendose rregullat e veta qe te reflektojne nevojat dhe kushtet e brendshme. Takimi dyditor i Washingtonit nuk do te kerkoje kufizime te detyruara te nivelit te gazeve qe shkaktojne efektin sere qe shkaktojne ngrohjen globale.

Shtetet e Bashkuara, Kina dhe India qe se bashku me vendet e tjera qe marrin pjese ne takim emetojne 80 perqind te ndotjes globale – kundershtojne shkurtimin e detyruar te gazeve qe shkaktojne efektin sere.

Zonja Rice tha se vendet duhet te bien dakort per objektiva afatgjata per pakesimin, krijimin e programeve kombetare afatmesme dhe per te punuar me industrine private per teknologji te reja.

Per me shume informacion:

<http://www.voanews.com/albanian/2007-09-27-voa6.cfm>

Njoftime

11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management

The International Water Association is going to organize 11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management on 4-5 September 2008 in Budapest.

The Call for Papers in electronic form (CfPe) which gives a summary of the most important information about the conference can be found on: www.iwa2008budapest.org

Water is a challenge for the century.

Exploring the sustainability of our most valuable resource is our business. IWA presents a unique opportunity to engage in 2 days of innovative discussion on the subjects of Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls and Monitoring and Modelling.

Join other experts in exchanging ideas and exploring networking opportunities during the IWA Watershed and River Basin Management Conference, 4-5 September 2008 in beautiful Budapest, Hungary. Mark this event on your calendar and begin to plan abstract / paper / poster today.

Topics of the Conference:

Include but are not limited to Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls, Monitoring and Modelling.

- River basin management planning under the EU Water Framework Directive;
- River basin management practices in different continents;
- Managing water resources in transboundary river basins with conflicting demand;
- Managing competing uses to protect water quality and quantity;
- Watershed management methods to facilitate water availability for aquatic ecosystem health and human uses;
- Interconnecting sub-watersheds to achieve basin goals;
- Hierarchical approaches to river basin management.
- Monitoring, ecological classification in EU countries and intercalibration;
- State-of-the-art in assessing water and biological quality and integrating data.;
- Programme of measures and ecological state.
- River basin management, advanced computation and decision support;
- The impact of climate change on watersheds, river basins, estuaries and reservoirs;
- Flood control and prevention.
- Effective methods to involve stakeholders and the public into the river basin management planning processes;
- Conflicts and multi-objective management – is it mostly methodology?
- Economics of River Basin Management.

The internet site of the conference is already open (www.iwa2008budapest.org) and interested candidates could submit abstracts under the Registration menu.

The abstract submission period is open until the end of September 2007.

C'eshte "Mjedisi Sot"

"Mjedisi Sot" eshte nje nga botimet periodike te Qendres Rajonale te Mjedisit - Zyra ne Shqiperi. Ne kete botim ditor do te gjeni lajme dhe probleme mjedisore nga shtypi i dites, informacion per aktivitete mjedisore nga vendi dhe bota.

Per t'u futur falas ne listen e shperndarjes se "Mjedisi Sot" ose per t'u cregjistruar, dergoni nje e-mail ne adresen: info@albania.REC.org

Versionin e shtypur mujor te "Mjedisi Sot" mund ta gjeni prane Zyres se REC ne Shqiperi.

Lajmet mjedisore ditore dhe "Mjedisi Sot" mujor mund t'i gjeni edhe ne internet: <http://albania.REC.org>
www.mjedisisot.info

C'eshte REC

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) per Evropen Qendrore e Lindore eshte nje organizate nderkombetare jopartizane, joavokate, jofitimpruese qe mbeshtet zgjidhjen e problemeve mjedisore ne Evropen Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkepunimin ndermjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktoreve te tjere mjedisore, si dhe duke mbeshtetur shkembimin e lire te informacionit dhe pjesemarrjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

REC eshte krijuar ne 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjerisht ne Karten e tij, nenshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe ne nje marreveshje nderkombetare me qeverine hungareze. REC ka zyren qendrore ne Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve ne secilin prej 16 vendeve perfituese. Shqiperia e ka nenshkruar Karten e REC ne 1992. Zyra e REC per Shqiperine eshte hapur ne 1994. Kjo zyre punon per realizimin e misionit te REC duke mbeshtetur organizatat jofitimpruese, institucionet mjedisore ne te gjitha nivelet, dhe aktore te tjere te interesuar ne fushen e mjedisit, duke mbeshtetur proceset pjesemarrese dhe shkembimin e lire te informacionit. Fushat kryesore te veprimtarise jane: Programi i granteve per OJF-te; Planet Lokale te Veprimit ne Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit per OJF-te dhe zyrtare te mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

Nese jeni te interesuar te njiheni me cfare ndodh cdo dite ne mjedisin shqiptar dhe neper bote, abonohuni falas ne "Mjedisi Sot", pakete e perditshme elektronike. Dergoni nje mesazh me titull "Abonim" tek info@albania.rec.org
